



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:076301

Datë: 01.03.2021

Numri i dokumentit: 01553107

NË EMËR TË POPULLIT

P nr.103/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P., gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu, në lëndën penale kundër të pandehurit B. B., sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr.202/19 të dt.13.2.2019, për veprë penale: të kanosjes nga neni 185 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit B. B. dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.01.3.2021 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. B. i lindur me dt., në fsh. Komuna e, ku edhe tani jeton, i biri i M. dhe nënës B. e gjinisë G., i njohur me dokument identifikues numës ka të kryer shkollën mesme, i pa punë, i martuar baba 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 23.1.2019, rreth orës 15:00, në në afërsi të Qendrës Tregtare “.....”, me qëllim të frikësimit, me fjalë seriozisht e kanos të dëmtuarin N. B. nga fsh. komuna e se do të shkaktojë ndonjë të keqe në atë mënyrë që në ditën kritike i pandehuri B. B. e ndjekë pas me automjetin e tij këtu të dëmtuarin duke e provokuar dhe duke ia zënë rrugën me ç’ rast sapo i dëmtuari ka vërejtur policinë ka dhënë sinjalizim që policia të ndalohet ku dhe i njëjti zbrit nga automjeti dhe afrohet tek policët për të lajmëruar rastin, me ç’ rast edhe i pandehuri zbrit nga automjeti dhe afrohet tek i dëmtuari ku edhe në prezencën e patrullës policore e kanos me fjalët duke i thënë “pse nuk po ndalesh, unë për ty jam zot” dhe më pas me fjalët kanosëse e merr vesh se kush jam unë ku ndërhyjnë zyrtarët policorë dhe për të pandehurin e larojnë nga aty.

-me çka ka kryer veprë penale: të kanosjes nga neni 185 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41,42,43,46, dhe nenit 185 par 1 të KPRK-së.

E G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej **200 € euro**, të cilën i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 3 muajsh , në rast të mospagimit gjoba në fjalë i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 (njëzet) euro për 1 (një) ditë burgu .

I pandehuri për shkak të gjendjes së varf[r ekonomike lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.13.2.2019 kundër të pandehurit B. B., ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.202/19, për vepre penale : të kanosjes nga neni 185 par 1 të KPRK-së ,duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit të cilin e ka kontaktuar përmes telefonit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë, që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, gjendjen e varfër ekonomike i pandehuri është mbajtës i vetëm i familjes prej 16 anëtarësh ku askush në familje nuk i punon , e në veçanti faktin se i dëmtuari përmes telefonit me numër 049-846-277 ka deklaruar se ndaj të pandehurit nuk parashtrij kërkesë për kompensimin e dëmit – të njëjtin e kam takuar shumë herë asnjë problem nuk e kam pas me te dhe se çfarëdo që vendos gjykata unë do ta respektoj , dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 01.3.2021.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .